



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-2466/24 datë:22.01.2024



Npi – 01/37 datë: 31.01.2024

RREGULLORE

PËR ORARIN E PUNËS TË BIZNESEVE

Shtime 2024



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-2466/24 datë:22.01.2024



Npi – 01/37 datë: 31.01.2024

Bazuar në nenin 11 nenin 12.1 dhe 12.2 shkronja (c) të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/2008); Nenin 40 të Ligjit për Tregtinë e Brendshme Nr.2004/18; Ligjin Nr.04/L-005 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr.2004/18 për Tregtinë e Brendshme; Ligjin për Kundërvajtje Nr.05/L-087; Rregulloren e MAPL-së Nr.01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimin e Akteve të Komunës; Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 date 03.09.2008; Kuvendi i Komunës, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë për Shërbime Publike dhe pas procesit të diskutimit publik, në seancën e mbajtur më 31.01.2024, Miratoi këtë:

RREGULLORE

PËR CAKTIMIN E ORARIT TË PUNËS PËR BIZNESET QË OPEROJNË NË TERRITORIN E KOMUNËS SË SHTIMËS

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Qëllimi

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet fillimi dhe mbarimi i orarit të punës për Bizneset që operojnë në territorin e Komunës së Shtimës.

Neni 2

Bizneset, në pajtim me nenin 1 të kësaj Rregulloreje, janë të obliguara t'i përmbahen orarit të punës, të përcaktuar me këtë Rregullore.

Neni 3

3.1 Orari i punës nënkupton periudhën kohore-fillimin dhe mbarimin e punës.

3.2 Orari për fillimin dhe mbarimin e punës, i përcaktuar me këtë rregullore, duhet të vendoset në hyrje apo në vend të dukshëm të objektit në të cilën kryhet veprimtaria e biznesit.

Përkufizimet

Neni 4

Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin si vijon:

4.1 Periudha verore nënkupton periudhën prej 01.04 deri 31.10 të vitit kalendarik.

4.2 Periudha dimërore nënkupton periudhën prej 01.11 deri 31.03 të vitit kalendarik.

4.3 Festë Zyrtare, ditë jo pune sipas kësaj rregulloreje nënkupton: Dita e Diel, 01 Janar (Viti i Ri), 15 Janari (Dita përkujtimore e Masakrës së Reçakut), 17 Shkurti (Dita e Pavarësis), Bajrami i Madh, dhe Bajrami i Vogël.

4.4 Përfshirje nga paragrafi 4.3 të këtijë neni bëjnë: Bizneset e gastronomisë, dhe Sallonet e zbukurimit (për femra).

II. ORARI I PUNËS TË BIZNESEVE

Neni 5

5.1 Floktarët, rrojtoret, sallonet e zbukurimit për meshkuj dhe veprimtaritë tjera të përafërta:

- 5.1.1 Periudha verore, prej orës 08:00 - 21:00,
- 5.1.2 Periudha dimërore, prej orës 08:00 - 19:00,
- 5.1.3 Në kuptim të nenit 4, paragrafit 3, nuk punohet.

5.2 Dyqanet e qepjes, këpucetarët, artarët, orëndreqësit dhe veprimtaritë e tjera të përafërta:

- 5.2.1 Periudha verore, prej orës 08:00 - 21:00,
- 5.2.2 Periudha dimërore prej orës 08:00 - 19:00,
- 5.2.3 Në kuptim të nenit 4, paragrafit 3, nuk punohet.

5.3 Sallonet e zbukurimit për femra dhe veprimtaritë e tjera të përafërta:

- 5.3.1 Periudha verore prej orës 08:00 - 21:00,
- 5.3.2 Periudha dimërore prej orës 08:00 - 19:00,
- 5.3.3 Në periudhën 01.06 deri më 31.08 mund të punojnë nga ora 5:00-21:00.

5.4 Auto serviset, serviset e mjeteve të tjera motorike dhe zejet e tjera të përafërta:

- 5.4.1 Periudha verore, prej orës 08:00 - 20:00,
- 5.4.2 Periudha dimërore prej orës 08:00 - 19:00,
- 5.4.3 Në raste specifike mund të punohet më gjatë, me kusht që lokali duhet të jetë i mbyllur.
- 5.4.4 Në kuptim të nenit 4, paragrafit 3, nuk punohet.

5.5 Auto-larjet, larja e orendive shtëpiake, larja e lokaleve dhe zyrave dhe veprimtaritë e tjera të përafërta:

- 5.5.1 Periudha verore, prej orës 08:00 - 21:00,
- 5.5.2 Periudha dimërore, prej orës 08:00 - 18:00,
- 5.5.3 Në kuptim të nenit 4, paragrafi 3, nuk punohet.

5.6 "Rent a car", marrjen/dhënien me qira të automjeteve/veturave (lizing):

- 5.6.1 Periudha verore, prej orës 08:00 - 24:00,
- 5.6.2 Periudha dimërore, prej orës 08:00 - 22:00,
- 5.6.3 Në kuptim të nenit 4, paragrafi 3, nuk punohet.

Neni 6

6.1 Qendrat tregtare, supermarketet, marketet dhe dyqanet e vogla ushqimore:

- 6.1.1 Periudha verore, prej orës 07:00 - 23:00,
- 6.1.2 Periudha dimërore, prej orës 07:00 - 23:00,
- 6.1.3 Orari i kujdestarisë për ditët e festave zyrtare dhe ditën e diel për Qendrat tregtare dhe supermarketet është nga ora 08:00 - 22:00,
- 6.1.4 Në kuptim të nenit 4, paragrafi 3, nuk punohet, përjashtohet biznesi që mbanë kujdestari, në ditën që mbanë kujdestari me orarë nga 08:00 - 22:00.

6.2 Dyqanet e tekstilit, këpucëve, pajisjeve teknike shtëpiake dhe veprimtaritë e tjera të përafërta:

- 6.2.1 Periudha verore, prej orës 08:00 - 22:00,
- 6.2.2 Periudha dimërore, prej orës 08:00 - 20:00,
- 6.2.3 Në kuptim të nenit 4, paragrafi 3, nuk punohet.

6.3 Dyqanet e kozmetikes, bizhuterive, dekorimeve dhe veprimtaritë e tjera të përafërta:

- 6.3.1 Periudha verore, prej orës 08:00 - 22:00,
- 6.3.2 Periudha dimërore, prej orës 08:00 - 21:00,
- 6.3.3 Në kuptim të nenit 4, paragrafi 3, nuk punohet.

6.4 Dyqanet tregtare te pajisjeve sanitare, të rrymës, ndërtimore dhe veprimtaritë e tjera të përafërta:

- 6.4.1 Periudha verore, prej orës 07:00 - 20:00,
- 6.4.2 Periudha dimërore, prej orës 08:00 - 19:00,
- 6.4.3 Në kuptim të nenit 4, paragrafi 3, nuk punohet.

6.5 Barnatoret bujqësore, dyqanet e pemëve dhe perimeve me pakicë, mishtoret dhe veprimtaritë e tjera të përafërta:

- 6.5.1 Periudha verore, prej orës 07:00 - 22:00,
- 6.5.2 Periudha dimërore, prej orës 07:00 - 21:00,
- 6.5.3 Ndalohet ekspozimi i mallit jashtë lokalit të punës,
- 6.5.4 Në kuptim të nenit 4, paragrafi 3, nuk punohet.

Neni 7

7.1 Veprimtaria ndërtimore (ndërtimi i ulët dhe i lartë) si dhe depotë ndërtimore:

- 7.1.1 Periudha verore, prej orës 07:00 - 18:00,
- 7.1.2 Periudha dimërore, prej orës 08:00 - 17:00,
- 7.1.3 Në kuptim të nenit 4, paragrafi 3, nuk punohet.
- 7.1.4 Bizneset ndërtimore, në raste të jashtëzakonshme, për shkak të natyrës së punëve dhe interesit publik, i lejohet te punohet me leje të posaçme, të cilën e lëshon Drejtoria për Shërbime Publike.

Neni 8

8.1 Gastronomia:

- 8.1.1 Periudha verore, prej orës: 06:00 - 24:00,
- 8.1.2 Periudha dimërore, prej orës: 07:00 - 23:00.

8.2 Hotelet, Motelet:

- 8.2.1 Gjatë gjithë vitit, prej orës 00:00 - 24:00,
- 8.2.2 Pas orës 24:00 nuk lejohet shërbimi në hapësirat e jashtme të objektit.

8.3 Internet - kafe, video lojëra, bilardot dhe veprimtaritë tjera të përafërta:

- 8.3.1 Periudha verore, prej orës 08:00 - 24:00,
- 8.3.2 Periudha dimërore, prej orës 08:00 - 24:00,
- 8.3.3 Në kuptim të nenit 4, paragrafi 3, nuk punohet.

8.4 Gastronomia/shërbimi merr me vete dhe porosi me dërgesë:

- 8.4.1 Gjatë gjithë vitit, prej orës 00:00 - 24:00.

8.5 Veprimtarive nga paragrafet 8.1, 8.2, 8.3 dhe 8.4 të nenit 8, gjatë orarit të punës nuk u lejohet të prishin qetësinë qytetarëve që banojnë në afërsi të lokaleve ku ushtrohet veprimtaria.

8.6 Të gjitha bizneset janë të obliguara të ushtrojnë veprimtarinë e tyre në pajtim me Ligjin për rendin dhe qetësin publike si dhe Ligjin për mbrojtje nga zhurma.

Neni 9

9.1 Orari i punës për gjellëtoret:

- 9.1.1 Periudha verore, prej orës 07:00 - 23:00,
- 9.1.2 Periudha dimërore, prej orës 07:00 - 22:00,

Neni 10

- 10.1 Stadiumet e futbollit, palestrat sportive, fitneset e të ngjashme punojnë prej orës 08:00-24:00
- 10.2 Pishinat e hapura, punojnë gjatë periudhës verore prej orës: 08:00 - 24:00.

Neni 11

11.1 Orari i punës për tregjet e qytetit dhe tregjet e lokaliteteve është:

- 11.1.1 Periudha verore, prej orës 07:00 - 20:00,
- 11.1.2 Periudha dimërore, prej orës 07:00 - 18:00,
- 11.1.3 Tregu i gjelbër në kuptim të nenit 4, paragrafi 3, nuk punohet,
- 11.1.4 Tregu i kafshëve punon të Premteve me orar sipas nevojës.

Neni 12

12.1 Pikat e shitjes së karburanteve:

- 12.1.1 Gjatë gjithë vitit: 00:00 - 24:00,
- 12.1.2 Ky orar vlen vetëm për shitjen e karburanteve kurse aktivitetet tjera brenda hapësirave të biznesit operojnë sipas orarit të përcaktuar me këtë rregullore.

Neni 13

13.1 Furrat e bukës:

- 13.1.1 Periudha verore, prej orës: 05:00 - 24:00,
- 13.1.2 Periudha dimërore, prej orës: 06:00 - 24:00,
- 13.1.3 Gjatë muajit të Ramazanit mund të punojnë deri në syfyr.

Neni 14

14.1 Veprimtarit e IT-se, telefonisë, arsimit, financave dhe të përafërta:

- 14.1.1 Periudha verore, prej orës: 08:00 - 23:00,
- 14.1.2 Periudha dimërore, prej orës: 08:00 - 21:00,
- 14.1.3 Në kuptim të nenit 4, paragrafi 3, nuk punohet.

Neni 15

15.1 Orari i punës në barnatore/farmacitë:

- 15.1.1 Periudha verore prej orës 08:00 - 20:00,
- 15.1.2 Periudha dimërore prej orës 08:00 - 20:00,

15.2 Barnatoret ndahen në tre zona: Zona I - barnatoret që gjinden në afërsi të QKMF-së së qytetit, Zona II - barnatoret që gjinden brenda qytetit si dhe Zona III - barnatoret të cilat operojnë nëpër fshatrat e komunës.

15.2.1 Orari i kujdestarisë të dielave dhe ditëve të festave zyrtare është nga ora 08:00-20:00, (Kujdestarohet nga barnatoret të cilat gjinden në zonat I - II),

15.2.2 Orari i kujdestarisë së natës prej orës 20:00-08:00, (Kujdestarohet nga një barnatore në zonën I si dhe zonën II.),

15.2.3 Orari i kujdestarive do të përgatitet nga Barnatoret së bashku, i cili do të silllet në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, për miratim.

15.3 Ordinancat private mjekësore:

- 15.3.1 Klinikat Specialistike prej orës 08:00 - 20:00,
- 15.3.2 Ordinancat Stomatologjike prej orës 08:00 - 20:00,
- 15.3.3 Laboratorët dhe Rëntgenet prej orës 07:00 - 19:00.

15.4 Ordinancat veterinere:

- 15.4.1 Periudha verore prej orës 07:00-24:00,
- 15.4.2 Periudha dimërore prej orës 08:00-24:00,
- 15.4.3 Në raste të nevojave emergjente lejohet puna më e gjatë se sa e paraparë në pika 4.1 dhe 4.2 të paragrafit 15.4.

15.5 Në kuptim të nenit 4, paragrafi 3, nuk punohet, përjashtim bëjnë barnatoret/farmacitë

që bëjnë kujdestari dhe ordinancat stomatologjike që mund të ofrojnë shërbime sipas nevojës.

15.5.1 Bizneset mund ta zgjasin orarin e punës me rastin e festave, të parapara me Ligjin për festat zyrtare, deri në orën 01:00 (të mëngjesit).

15.5.2 Për të gjitha rastet e parapara në pikën 1 të këtij neni, nuk paguhet taksa shtesë.

15.5.3 Bizneset që dëshirojnë të punojnë më shumë se orari i përcaktuar me këtë rregullore, mund të parashtrijnë kërkesë në Drejtorinë për Shërbime Publike, e cila pas shqyrtimit, mund të lëshojë leje të posaçme për zgjatje të orarit, por jo më shumë se deri në ora 02:00. Për qdo orë shtesë duhet të paguhet taksa prej 50.00 euro. Meqenëse kjo mundësi u jepet bizneseve që për çfarëdo llojë nevoje apo situatë të punojnë më gjatë, biznesi duhet të ofrojë dëshmi bindëse për orarin shtesë dhe këtë mund ta shfrytëzojnë deri në 3 (tre) herë gjatë vitit.

Neni 16

Orari i punës për veprimtaritë e zyrave të punës, veprimtarive profesionale shkencore, teknike dhe veprimtaritë e tjera ekonomike financiare si; Për avokatë, noterë, përmbartues privat, banka, mikrobanka, agjensione turistike, agjensione të patundshmërive, kompani të sigurimeve, zyrave të arkitekturës dhe inzhinierisë, zyrave të analizave dhe testeve teknike, sportele të pagesave, zyra juridike dhe ekonomike (kontabilist, auditor), zyra të përkthyesve, zyra gjeodezike, këmbimore dhe të tjera të ngjashme, gjatë ditëve të javës për periodën verore dhe dimërore është si vijon:

16.1 E hënë – premte nga ora 08:00 deri 16:00,

16.2 E shtunë mund të punohet prej orës 09:00 – 14:00,

16.3 Në kuptim të nenit 4, paragrafi 3 nuk punohet.

Neni 17

17.1 Bizneset prodhuese dhe ato përpunuese mund të punojnë sipas vëllimit dhe nevojave të tyre por duke respektuar standardet, sigurinë dhe qetësin publike.

17.2 Bizneset që nuk janë të përfshira në dispozitat e kësaj Rregulloreje e propozojnë orarin e punës të cilin në formë të shkruar me pëlqim e aprovon Drejtoria për Shërbime Publike.

Neni 18

Ndalohet ekspozimi i të gjitha produkteve, në ambientet e jashtme të lokalit nga të cilat mund të ketë dëmtime/prishje të atyre produkteve.

Neni 19

Kryetari i Komunës mundet me vendim të posaçëm, kur e kërkon interesi publik, të lejojë punën e bizneseve në kuptim të nenit 4, paragrafi 3 - sipas nenit 19 të kësaj Rregulloreje.

Neni 20

Në rastet siç janë fushata e të mbjellurave, korrje shirjeve, ardhja nga diaspora e bashkatdhetarëve etj. Organi kompetent mund të nxjerrë vendim për ndryshimin e përkohshëm të orarit të punës.

Neni 21

Në ditën e dielë, lejohet të punohet sipas orarit të ditëve të punës, vetëm në rastet kur, festa-t, qëllon në dy ditëshin e parë të javës (e hënë e martë).

Neni 22

Orari i kujdestarisë së marketeve duhet të jetë i harmonizuar dhe do të përcaktohet nga organet kompetente komunale.

Vendosja e simboleve shtetërore

Neni 23

Të gjitha veprimtaritë ekonomike janë të obliguara që gjatë festave zyrtare të vendosin në vend të dukshëm flamurin shtetëror.

III. DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 24

24.1 Bizneset do të gjobiten për kundërvajtje në qoftë se veprojnë në kundërshtim me të gjitha nenet e kësaj rregulloreje:

24.1.1 Personat fizik.....100 - 250 Euro

24.1.2 Personat juridik.....500 - 1500 Euro

24.1.3 Në rastet kur konstatohet se janë shkelur dispozitat e kësaj Rregulloreje, Inspektorati komunal duhet brenda afatit prej tetë (8) ditësh kalendarike nga dita e konstatimit të shkeljes të shqiptojë gjobë.

24.1.4 Gjobat të përcaktuara me këtë Rregullore paguhen brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e shqiptimit të tyre.

24.1.5 Nëse subjekti i gjobitur bënë pagesën e gjobës së shqiptuar me këtë Rregullore brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, subjekti lirohet nga pagesa prej pesëdhjetë për qindë (50%) e shumës së gjobitur.

24.1.6 Kundër vendimit të Inspektorit komunal për shqiptimin e gjobës pala ka të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditëve në Komisionin për ankesa të komunës. Ankesa kundër vendimit të Inspektorit komunal nuk e ndalon ekzekutimin e Vendimit.

IV. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 25

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje kujdeset Drejtoria për Shërbime Publike sektori i Inspektoratit Komunal, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës.

Neni 26

26.1 Të gjitha bizneset janë të obliguara që të harmonizojnë orarin e tyre të punës me dispozitat e kësaj Rregulloreje, në afatin prej (30) ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

26.2 Ditët e punës gjatë javës, nuk mund të zëvendësohen si ditë pushimi në vend të ditës e dielë.

Neni 27

Të gjitha llojet e bizneseve të cilat nuk janë të parapara në këtë rregullore, duhet ta respektojnë orarin nga 07:00-21:00

Hyrja në fuqi

Neni 28

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.



KRYESUESI I KUVENDIT

Adnan Ademi